



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Received	Dorëzuar / Delivered	02.10	3	viti / god / year
Organ / Mjeshtja / Org. / Unit	Kr. Prind / Bz. Prind / Prind. No.	Shtojta / Pafilog / Appendix		Sasia / Kolicitna / Quantity
SKPM/SHUK	6364/2023			1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1106/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Sabile Avdyli-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1106/2023, të datës 23.08.2023, të parashtruar nga ankuesja _____ nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, në çështjen juridike „kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 02.10.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet ankesa e ankueses nën shenjën A.nr.1106/2023, e datës 23.08.2023, e parashtruar nga ankuesja _____

A r s y e t i m

Nëpunësja civile _____ (tutje vetëm ankuesja) më datë 23.08.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.1160/2023, kundër përgjigjes të datës 14.08.2023, të Drejtoreshës së Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit, për shkak të mos njohjes së të drejtës në kompensim material lidhur me shtesën për vëllim të punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (këtu e tutje vetëm Këshilli) në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 25.08.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit, ndërsa, kjo e fundit, më datë 01.09.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar kësaj çështje juridiko-administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5781/2023 të datës 23.08.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në kërkesë të datës 14.08.2023 përmes e-mailit zyrtar nga Drejtoresha e ARRU-së; Kërkesën e ankueses të datës 26.07.2023 përmes e-mailit zyrtar për tek Drejtoresha e ARRU-së; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 25.08.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 01.09.2023 nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës: Kërkesën e datës 11.08.2023 përmes e-mailit zyrtar nga nëpunësi R.H.K për Drejtoreshën e ARRU-së; Akt emërimit e ankueses me numër 236 të datës 25.03.2019; Formularin mbi përshkrimin e detyrave të punës së ankueses me numër 236/2 të datës 25.03.2019si dhe Kërkesën e datës 09.08.2023 përmes e-mailit zyrtar nga Drejtoresha e ARRU-së për tek F.H dhe A.A.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se çështja të kthehet në rishqyrtim të organi i punësimit, **sepse:**

Nga administrimi i prova të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se se ankuesja është e punësuar në Autoritetin e Rregullator për Shërbimet e Ujit dhe se e njëjta sipas Aktit të emërimit me numër Nr.236, të datës 25.03.2019, ushtron pozitën e punës *Analiste e performances teknike* (Zyrtare alternative e pranimit), në Departamentin për Raportim të Performances.

Me datë 26.07.2023 përmes e-mailit zyrtar ankuesja ka parashtruar kërkesë pranë Drejtoreshës së Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit me inicialet H. M, lidhur pagesën e shtesës për vëllim të punës, për shkak se e njëjta kryen edhe detyrat e punës së një pozite tjetër, në mungesë së nëpunëses e cila gjendet në pushim të lehonisë.

Në përgjigje të kërkesës së ankueses të datës 26.07.2023, Drejtoresha e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit me inicialet H. M, me datën 14.09.2023 ka njoftuar ankuesin së kërkesa e saj nuk mund të aprovohet, me arsyetimin se nuk janë respektuar procedurat sipas Ligjit Nr.08/L-196 si dhe se institucioni në fjalë ka mungesë buxhetore për të mbuluar të gjitha punët shtesë të stafit të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit.

Në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji iu referuar dispozitave ligjore në fuqi që rregullojnë kompensimit pagesës për vëllim të punës, përkatësisht Kolegji iu referua nenit 28 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me të cilin është përcaktuar se: *“Organizatat buxhetore, në rastet e parashikuara nga ky ligj, mund të japin shtesën për vëllim të punës, për kryerjen e punës për shkak të rritjes së vëllimit të punës, nëse kanë mjete në dispozicion për këtë qëllim nga kursimet e fondeve të pagave që krijohen për shkak të mungesës së nëpunëseve/ve civil, apo pozitive të paplotësuara për të cilat janë paraparë mjete në planin financiar të shfrytëzuesit buxhetor dhe fonde për projekte të veçanta. 2. Nëpunëset/it civil përfitojnë shtesën për shkak të rritjes së vëllimit të punës, për punën e kryer dhe që tejkalon rezultatet e pritshme të punës në një (1) muaj, nëse në këtë mënyrë është e mundur të sigurohet një mënyrë më racionale arritja e rezultateve të punës si dhe buxheti. 3. Shtesa për vëllimin e punës miratohet nga zyrtarja/i kryesor administrativ i institucionit, pas marrëveshjes me nëpunësen/in civil për të punuar me vëllim të shtuar. 4. Shtesa e përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni, nuk mund të jetë më e lartë se 0.5% e*

fondeve totale të përdorura nga organizata buxhetore, për pagën bazë të zyrtareve/ëve publik të organizatës buxhetore në të njëjtin vit financiar. ... si dhe Rregullores (QRK) Nr.08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, me theks të veçantë dispozitive të nenit 8 dhe 9 të kësaj rregullore ku përcaktohet se: Neni 8: Shtesa për vëllimin e punës 1. Organizatat buxhetore, mund të japin shtesën për vëllim të punës, për kryerjen e punës për shkak të rritjes së vëllimit të punës, nëse kanë mjete në dispozicion për këtë qëllim nga kursimet e fondeve të pagave që krijohen për shkak të mungesës së nëpunësve civil, apo pozitive të paplotësuarra për të cilat janë paraparë mjete në planin financiar të shfrytëzuesit buxhetor dhe fonde për projekte të veçanta. 2. Shtesa për vëllimin e punës përfitohet nga nëpunësit civil, për punën e kryer për shkak të rritjes së vëllimit të punës dhe që tejkalon rezultatet e pritshme të punës në një (1) muaj”, Neni 9: **Kriteret dhe procedura për përfitimin e shtesës për vëllimin e punës 1.** Shtesa për vëllimin e punës mund të përfitohet nëse në këtë mënyrë është e mundur të sigurohet në mënyrë më racionale arritja e rezultateve të punës, si dhe buxheti. 2. Udhëheqësi i Njësisë dhe/apo Zyrtari Kryesor Administrativ mund t’i kërkojë një apo më shumë nëpunësve civil që të angazhohen me vëllim të shtuar të punës për një periudhë të caktuar kohore që nuk e tejkalon një (1) vit. 3. Periudha kohore e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni mund të vazhdohet me marrëveshje të re dhe pëlqimin e të dyja palëve. 4. Në asnjë rast totali i periudhës në të cilën nëpunësi civil punon me vëllim të shtuar nuk mund të kalojë periudhën prej dy (2) viteve të njëpasnjëshme. 5. Shtesa për vëllimin e punës miratohet me lidhjen e marrëveshjes nga zyrtari kryesor administrativ i institucionit me nëpunësin civil për të punuar me vëllim të shtuar, sipas Shtojcës 1, pas konfirmimit nga njësi përkatëse për buxhet dhe financa se nuk është tejkalar limiti buxhetor, komfor njoftimit të përcaktuar në paragrafin 10 të këtij neni. 6. Vlera e shtesës për vëllim të punës është deri në njëzetë për qind (20%) e pagës bazë të nëpunësit civil. 7. Shtesa për vëllimin e punës duhet të ndërpritet në momentin e pushimit të ekzistimit të rrethanave për të cilën është dhënë shtesa. 8. Përderisa nuk përcaktohet ndryshe me ligj, tërësia e shtesave të dhëna sipas këtij neni nuk mund të jetë më e lartë se 0.5% e fondeve totale të përdorura nga organizata buxhetore, për pagën bazë të zyrtarëve publik të organizatës buxhetore në të njëjtin vit fiskal. 9. Për qëllim të zbatimit të këtij neni, Qeveria e Republikës së Kosovës do të trajtohet si një (1) organizatë buxhetore. 10. Ministri përkatës për financa, brenda kufizimeve ligjore, priorizon shpërndarjen e fondeve në dispozicion për shtesën e vëllimit të punës sipas paragrafit 8 dhe 9 të këtij neni tek institucionet dhe i njofton, duke marrë parasysh kriteret si në vijim: 10.1. numrin e të punësuarve në Organizatën Buxhetore dhe mungesat e stafit; dhe 10.2. organizatat buxhetore ku fusha e përgjegjësisë administrative e dy (2) apo më shumë ministrive është bashkuar/fuzionuar në një ministri. 11. Ministria përgjegjëse për financa ka për obligim që të sigurohet se totali i shtesave për vëllim të punës, nuk tejkalon kufirin e përgjithshëm buxhetor të përcaktuar me legjislacionin në fuqi”.

Rrjedhimisht në kuptim të kuadrit ligjor si më sipër si dhe duke u bazuar në shqyrtimin e provave të lëndës, Kolegji konstatoi së lidhur me rastin e përftimit të së drejtës së ankueses për kompensim material, në emër të shtesës për vëllim të punës, nuk janë plotësuar asnjëra nga kërkesat dhe kriteret ligjore të përcaktuara me dispozita ligjore si me lartë, ngase, nga shkresat e lëndës nuk ka vendim apo ndonjë parashtrëse tjetër mbi caktimin e ankueses që të ushtroj detyrat e koleges së saj, e nga i cili vendim do të identifikoheshin detyrat që ankuesja ushtron dhe data kur këto detyra i janë bart si shtesë. Po ashtu, në provat e kësaj çështje nuk ekziston ndonjë marrëveshje e lidhur mes ankueses dhe zyrtarit me të lartë të institucionit lidhur me pagesën e shtesës për vëllim të punës dhe së bazuar në përgjigjen e Drejtoreshës së Autoriteti

Rregullator për Shërbimet e Ujit të datës 14.08.2023 si dhe në përgjigjen e dhënë në ankesë të datës 01.09.2023, konfirmohet se institucioni në fjalë, nuk ka buxhet të mjaftueshëm për kompensimin e nëpunësve konkretisht të ankueses për vëllim të punës, andaj, mbi bazën e këtyre fakteve rrjedhë së janë të pabazuar pretendimet ankimore të ankueses për kompensim të shtesës për vëllim të punës.

Nisur nga konstatimet si me sipër, Kolegji i Këshillit bazuar në nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132, paragrafi 2, të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1106/2023

Sabile Avdyli
Sabile Avdyli
Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtoreshës së Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.